



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr. 08/2017
Prishtinë, më 13.12.2017, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Dardan Molliqaj, Qëndron Kastrati, Memli Krasniqi dhe Gani Dreshaj, anëtarë.

Të ftuar: Mariana Gorvos, Gabor Baranyai dhe Daniel Mondekar – EU Tëinning Project.

Pjesëmarrës të tjerë: Etleva Malushaj –GPP/LVV, Dardan Abazi – INDEP, Agnesa Haxhiu – KDI, Albert Krasniqi - KDI, Kaltrina Zymeri – Ekonomia Online, Mariana Gorvos - EU Tëinning, Gabor Baranyai – EU Tëinning dhe Daniel Mondekar – EU Tëinning.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutimi rreth sfidave kryesore legjislative dhe politikave lidhur me procesin e MSA-së me Projektin e Binjakëzimit;
3. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Diskutimi rreth sfidave kryesore legislative dhe politikave lidhur me procesin e MSA-së me Projektin e Binjakëzimit

Kryetarja i uroi mirëseardhjen ekipit të Projektit të Binjakëzimit, dhe ia dha fjalën përfaqësueseve të projektit të binjakëzimit për të prezantuar përvojat e vendeve të tyre, lidhur me sfidat dhe politikat në procesin e MSA-së.

Mariana Gorvos, Projekti i Binjakëzimit në Kuvend, përshëndeti deputetët për këtë takim dhe theksoi se me mua janë Gabor Baranyai nga Ministria e Drejtësisë e Hungarisë dhe Daniel Mondekar nga Kroacia dhe e ftoi Gabor Baranyai që ta bëjë prezantimin e tij.

Gabor Baranyai, në prezantimin e tij “Çështjet kritike të politikës ekonomike në procesin e asociimit dhe të anëtarësimit”, foli për temat në vijim: për evoluimin e politikës ekonomike të BE-së që nga Unioni Doganor tek Unioni Ekonomik dhe Monetar; për çështjet ekonomike në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit; për prezentimin e sfidave ekonomike të Hungarisë gjatë procedurave të anëtarësimit dhe rezultatet.

Hykmete Bajrami theksoi se kur po dëgjojmë përvojat e vendeve të tjera, në procesin integrues, kjo po e rrit dozën e pesimizmit për neve se si do ta kalojmë periudhën e integrimit në BE, kur para se gjithash vetë politikat e zgjerimit të BE-së nuk janë të qarta në periudhën e mëtuftjeshme. Sot ne kemi një ekonomi komplet të hapur por lëvizja e biznesmenëve tonë është komplet e kufizuar dhe kjo është një pozitë jashtëzakonisht e pafavorshme. Te prokurimi publik janë çmimet preferenciale dhe është me interes të dimë më shumë se si ka shkuar ky proces sepse në fakt ne kur kemi vendosur një diskriminim pozitiv për kompanitë vendore. Po ashtu, më intereson të dijë nga praktika e Hungarisë në efikasitetin e shfrytëzimit të fondeve të BE-së.

Mimoza Kusari – Lila kërkoi që të elaborohet më shumë pjesa e ndihmës shtetërore për ndërmarrjet publike, dhe pyeti sa ka qenë involvimi i fondeve të BE-së në avancimin e shërbimeve që afrojnë ndërmarrjet publike, si termocentrale, ngrohtore, etj.?

Dardan Sejdiu pyeti për politikat e agrikulturës në procesin e integrimit, cilat janë barrierat qofshin ato jo tarifore apo të unifikuara për shtetet siç është Kosova? Çfarë lloje standardi duhet të arrihet për të qenë konkurrent? Po ashtu pyeti se a ka ndonjë kufizim apo cili është kulmi i pronësisë së shtetit në ndërmarrjet publike. Ai pyeti se si mund të ndodhë që në vitin 2017 të kërkohet ekonomia e lirë e mallrave e në fakt kufizohet lëvizja e lirë e njerëzve, cila është logjika e gjithë kësaj?

Gabor Baranyai, duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, theksoi se sikur të kishte edhe lëvizje të lirë të njerëzve atëherë gjysma e shtetit do të largohej jashtë. Ai potencoi se mund ta mbani pronësinë në ndërmarrjet publike, por duhet ta bëni konkurrues. Sa i përket prokurimit publik theksoi se nuk mund të kufizohet vetëm ndërmarrjet vendore. Ai në vazhdim iu përgjigj edhe pyetjeve të tjera që parashtruan deputetët.

Daniel Mondekar, në prezantimin e tij për “Çështjet kyçe të procesit të MSA-së”, foli për përvojën kroate në procesin e integritit evropian. Ai në vijim foli për: fazat e përafrimit të legjislacionit; konsensusin nacional; çështjet ekonomike, infrastrukturore, tregtare dhe industriale; sfidat kryesore të negociatave; rolin e komisioneve të linjës; bashkëpunimin me Komisionin për Integritime Evropiane; bashkëpunimin me Qeverinë dhe çështje të tjera të karakterit ekonomik.

Kryetarja kërkoi të sqarohet se çka nënkuptohet me reformat e dhimbshme ekonomike dhe si është vepruar?

Daniel Mondekar sqaroi se reformat e dhimbshme kanë të bëjnë me atë se kemi menduar se pas luftës së Kroacisë dhe pas privatizimit do të punësohen shumë punëtorë nëpër fabrika, por nuk ka ndodhur kjo, kemi pasur shumë më pak të punësuar. Nuk kemi arritur ta adresojmë mirë këtë problem. Mjetet nga privatizimi janë destinuar në politika të punësimit, por nuk është një përvojë e mirë, dhe nuk do t’ua sugjeroja.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Mirëpritën ekipet e ekspertëve nga Projekti i Binjakëzimit, por edhe ekspert e tjerë nga Bashkimi Evropian, për prezantimin e përvojave të vendeve të tyre në procesin e MSA-së dhe të integritit evropian në përgjithësi.

3. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në ora 13:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit

Kryetare e komisionit,

Sala Berisha – Shala